



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

3002/2
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 02 / 10 / 2025

URDHËR

Nr. 594, Datë 02.10.2025

"PËR CAKTIMIN E DITËS, ORËS, VENDIT TË ZHVILLIMIT TË PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR NDËRMJETËS, AFATIT TË PARAQITJES SË KËRKESAVE PËR SHPREHJE INTERESI PËR TË HYRË NË PROVIM DHE DOKUMENTEVE PËRKATËSE QË DUHET TË SHOQËROJNË KËRKESËN"

Në mbështetje të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 10385/2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar, të pikës 3 dhe 4 të Urdhrit nr. 90, datë 23.02.2021 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores së Provimit të Kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit",

URDHËROJ:

1. Caktimin e datës 21.11.2025, ora 16:00, për zhvillimin e provimit të kualifikimit për ndërmjetës, në Sallën e Konferencave të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Paraqitjen e kërkesave për shprehjen e interesit për të hyrë në provimin e kualifikimit për ndërmjetës, jo më vonë se 21 ditë përpara ditës së organizimit të provimit, të caktuar në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Çdo kërkesë për shprehjen e interesit si më sipër, duhet të shoqërohet nga dokumentacioni si vijon:
 - a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID),
 - b. Jetëshkrim,
 - c. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti),
 - d. Diplomë e noterizuar për përfundimin e studimeve të ciklit të dytë dhe listën e notave, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë;
 - e. Kopje e noterizuar e çertifikatës së përfundimit të programit të trajnimit fillestar,
 - f. Kopje të noterizuar të librezës së punës ku të vërtetohet eksperiencia profesionale jo më pak se tre vjet.
4. Ngarkimin e Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, për marrjen e masave për zbatimin e këtij urdhri.

5. Publikimin e këtij urdhri në:

- a. Buletinin e Njoftimeve Zyrtare,
- b. Faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe,
- c. Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

BESFORT LAMALLARI

